

**Njoftim për takim lidhur me detyrimin ekonomik për fëmijën**  
*Shmangni reduktimin e përfitimeve tuaja duke marrë pjesë në takim*  
**(Albanian)**

Ju mirëpresim që të flasim së bashku në takimin tuaj të detyrueshëm lidhur me detyrimin ekonomik për fëmijën.

Intervista juaj do të zhvillohet:

- Me telefon më (DATË) \_\_\_\_\_ ndërmjet orës 9:00 dhe 17:00. Një anëtar i stafit të mbështetjes financiare për fëmijën do t'ju telefonojë në \_\_\_\_\_ për intervistën tuaj të detyrueshme.

Nëse Agjencia nuk e ka numrin tuaj të telefonit ose nëse e keni ndryshuar atë, ju lutemi të na kontaktoni në \_\_\_\_\_ të paktën 24 orë përpara për të na njoftuar.

- Ballë-për-ballë më (DATË) \_\_\_\_\_ në (ORA) \_\_\_\_\_. Ju lutemi të paraqiteni në vendndodhjen në vijim për intervistën tuaj të detyrueshme:

Emri i vendndodhjes:

Adresa: \_\_\_\_\_

Qyteti: \_\_\_\_\_ Shteti: \_\_\_\_\_ Kodi postar: \_\_\_\_\_

Para takimit, plotësoni dhe dorëzoni formularin e Regjistrimit për detyrimin ekonomik për fëmijën dhe dorëzoni dokumentet mbështetëse. Në këtë paketë do të gjeni informacione lidhur me dokumentet që duhet të dorëzoni dhe mënyrën se si duhet t'i dorëzoni ato.



Para se të shkoni në takim, lexoni “**LDSS-4279 Njoftimin për përgjegjësitë dhe të drejtat në lidhje me mbështetjen financiare**” dhe “**W-280a Informacionin për të gjithë aplikantët për detyrimin ekonomik për fëmijën në lidhje me marrjen e detyrimit për ushqim për fëmijën në mënyrë të sigurt**”. Nëse keni shqetësime në lidhje me sigurinë pas leximit të këtyre dokumenteve, kontaktoni punonjësën tuaj të FIA-s, i cili do t'ju referojë te një Koordinator i HRA-së për Dhunën në Familje. Së bashku mund të vendosni nëse marrja e detyrimit ekonomik për fëmijën është një veprim i sigurt për familjen tuaj.

Kopjet dhe përkthimet e këtij dokumenti dhe të gjithë dokumenteve të referuara janë të disponueshme në adresën <https://on.nyc.gov/custodialparent> ose mund të përdorni kodin QR në të djathtë.



### **A keni nevojë të ndryshoni takimin tuaj?**

Për shembull, keni një takim fizik por dëshironi një takim me telefon. Na telefononi për të kërkuar një ndryshim. Është e rëndësishme të na telefononi në \_\_\_\_\_ të paktën 24 orë para për të na njoftuar.

### **Çfarë ndodh nëse nuk paguaj detyrimin ekonomik për fëmijën?**

Nëse nuk paguani, mund t'ju reduktohen përfitimet si më poshtë:

- Ndhma ekonomike mund t'ju reduktohet me të paktën 25%;
- Mund të humbisni shërbimet e Medicaid-it për veten;
- Mund të mos kualifikoheni më për disa programe të ndihmës për qiramarrje ose mund t'ju reduktohet mbështetja financiare për shpenzimet e qirasë;
- Në momentin që nuk do të keni më nevojë për ndihmë ekonomike, nuk do të merrni deri në \$200 në muaj si pagesa për detyrimin për ushqim për fëmijën krahas përfitimit të ndihmës ekonomike dhe do të humbisni dhe përfitime të tjera.



**A keni ndonjë problem shëndetësor ose problem me shëndetin mendor apo aftësi të kufizuara?** A e keni të vështirë për shkak të kësaj gjendjeje të kuptoni atë çfarë thuhet në njoftim apo të bëni atë që ju kërkohet? A e keni të vështirë për shkak të kësaj gjendjeje të merrni shërbime të tjera në Administratën e Burimeve Njerëzore (Human Resource Administration, HRA)? **Ne mund t'ju ndihmojmë.** Na telefononi në numrin **718-557-1399**. Gjithashtu, ju mund të kërkonti ndihmë duke u paraqitur në zyrën e HRA-së. Ju gëzoni të drejtën të kërkonti këtë lloj ndihme në zbatim të ligjit.